

Procesverbali nga Kuvendi i parë zgjedhor i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Krijuesve Shqiptarë në Austri (LShKShA) "Aleksandër Moisiu"-Vjenë

Data: 6 dhjetor 2015 (e diel)

Vendi: Keplerplatz 5, 1100 Wien

Koha: 12.00-15.30

Rendi i ditës i kuvendit të parë zgjedhor të LShKShA

- Hapja e punimeve të kuvendit
- Fjalët përshëndetëse
- Leximi, diskutimi, plotësimi dhe aprovimi i raportit të punës dhe atij financiar (2011-2015)

Paузë

- Prezantimi i planit të veprimit të LShKShA "Aleksandër Moisiu" për vitin 2016
- Pranimi i anëtarëve të rinj dhe zgjedhja e kryesisë së re
- Të ndryshme

Hapja e Kuvendit:

Hapjen e kuvendit e bëri Anton Marku, sekretar i LShKShA. Ai fillimisht i përshëndeti të pranishmit duke i falënderuar ata për pjesëmarrje në këtë aktivitet. Më pas ai ftoi kryetarin Besim Xhelili që të marrë fjalën. Kryetari Xhelili duke u dëshiruar mirëseardhje pjesëmarrësve në kuvend, falënderoi për ardhjen e tyre sidomos përfaqësuesin e Ambasadës së Republikës së Kosovës në Vjenë, sekretarin e tretë Faruk Ajetin, përfaqësuesit e Këshillit Koordinues të Shoqatave Shqiptare në Austri (KKShShA), të Asociacionit të Rinjve dhe Studentëve Shqiptarë në Austri, etj. Në vazhdim ai propozoi kryesinë e punës së kuvendit, në përbërje: Hazir Mehmeti, kryesues, Ragip Dragusha, zëvendëskryesues dhe Jehona Muja, anëtare. Pasi kjo kryesi e punës u aprovua nga kuvendi, ajo mori drejtimin e punimeve të kuvendit.

Fjalët përshëndetëse:

Në emër të Ambasadorit të Republikës së Kosovës në Vjenë, z. Sami Ukelli, me një fjalë rasti kuvendit iu drejtua Faruk Ajeti, sekretar i tretë pranë kësaj ambasade. Pos tjerash, ai përgëzoi kryesinë e LShKShA për aktivitetet e tyre përgjatë katër viteve të shkuara si dhe rikonfirmoi gatishmërinë e Ambasadës së Kosovës në Vjenë për të mbështetur edhe më tutje punën e këtij subjekti kulturor shqiptar në Austri. Në emër të Këshillit Koordinues të Shoqatave Shqiptare në Austri takimin e përshëndeti Dr. Sabri Osmani, duke vlerësuar lartë bashkëpunimin mes organizatës që përfaqëson dhe LShKShA. Në vazhdim fjalën e mori Dr. Ina Arapi, e cila, duke çmuar përpjekjet e LShKShA, theksoi se komuniteti shqiptar në Austri është mirënjohës, sot dhe në të ardhmen, për kontributin e krijuesve shqiptarë në afirmimin e vlerave tona në këtë shtet.

Leximi, diskutimi, plotësimi dhe aprovimi i raportit të punës dhe atij financiar (2011-2015)

Raporti i punës:

Kryetari i LShKShA Besim Xhelili, pasi bëri të njohur rendin e ditës, paraqiti raportin e punës për vitet 2011-2015. Ai së pari prezantoi një historik të shkurtër të Lidhjes. Më pas u fokusua në bashkëpunimin me shoqata, klube, organizata, subjekte, institucione dhe individë të ndryshëm në Austri. Ndër sukseset e LSHKSHA "A. Moisiu" ai veçoi këto:

- Organizimi i rreth 40 orëve letrare në Austri, në vendlindje dhe në diasporë, nga të cilat rreth 12 të fundit në dy gjuhë;
- Botimi i disa librave individualë të autorëve-anëtarë të Lidhjes;
- Botimin e antologjisë së parë të krijuesve shqiptarë në Austri "Illyricum" me rastin e 100-vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë. Një vit më pas u botua edhe versioni në gjuhën gjermane, i pasuruar me më shumë krijues nga të gjitha trevat shqiptare që jetojnë dhe punojnë të shtrirë gjithandej Austrisë;
- Kontributi në themelimin e Lidhjes së Krijuesve Shqiptarë në Mërgatë (LKSJM), në nëntor 2013 në Koblenz të Gjermanisë;
- Pjesëmarrja në Javën e Kulturës Shqiptare në Austri (2014 dhe 2015) në bashkëpunim me KKSHTA, etj.

Sipas Xhelilit sfidat kryesore me të cilat u përball Lidhja dhe me të cilat do të mund të ballafaqohemi edhe në të ardhmen, janë: sigurimi i mjeteve materiale për të mbështetur organizimet e ndryshme, realizimi i planit vjetor të punës, botimi i krijimeve tona në antologji të ndryshme të Lidhjeve apo klubeve të ndryshme me autorë vendas, gjetja e një lokacioni për zyrë, afrimi i krijuesve të rinj, hapja e një konkursi të dytë letrar në prozë, poezi dhe lëmi të tjera dhe me këtë nxitja e masës që merret me shkrime. Këtu bëjnë pjesë edhe:

- Vazhdimi i botimit të antologjive të përbashkëta të autorëve shqiptarë në Austri;
- Anëtarësimi ynë në Lidhjen e Shkrimtarëve të Austrisë, në PEN Klub, etj;
- Shtypja e nje reviste në shqip dhe gjermanisht një herë në një apo tre muaj;
- Përfitimi i donacioneve nga MA7 dhe MA17 me qëllim të realizimit të projekteve të rëndësishme që ndërlidhen me integrimin tonë në shoqërinë ku jetojmë;
- Tërheqja e donatorëve që të reklamojnë ndërmarrjet e tyre në webfaqen e Lidhjes sonë, etj.

Pas këtij prezantimi kuvendi vazhdoi me diskutimet rreth raportit të punës. Në këtë kontekst, anëtari i Lidhjes, Zef Ndrecaj, pos aspekteve pozitive lidhur me punën e bërë, ngriti edhe disa shqetësime të debatuar nga disa anëtarë të Lidhjes, si: transparencë e pamjaftueshme në procesin e botimit dhe kualiteti jo dhe aq i lartë i antologjisë së parë të krijuesve shqiptarë

në Austri "Illyricum" (publikuar në vitet 2012 dhe 2013), si dhe propozoi që të analizohet mundësia që zhvillimi i aktiviteteve të Lidhjes në Vjenë të koordinohet më mirë me anëtarët tjerë jashtë Vjenës, sidomos në aspektin kohor. Ai sugjeroi që Lidhja të përpilojë reagime me shkrim lidhur me sfidat nëpër të cilat po kalojnë momentalisht Shqipëria dhe Kosova dhe potencoi nevojën e afimit të mëtejshëm të krijuesve nga qytetet tjera në Austri. Nga ana tjetër, Prekë Brahimi, po ashtu anëtar i Lidhjes, njoftoi për qëndrimin e tij disajavor gjatë muajit gusht 2015 në SHBA dhe takimet me kryetarin e Shoqatës "Vatra" Gjon Buqaj. Në diskutime kontribut dhanë edhe aktivisti dhe anëtari i kryesisë së KKShShA, Salih Gashi, Dr. Ina Arapi, Ragip Dragusha, Zaim Toska, etj.

Në këtë aspekt Faruk Ajeti, sekretar i tretë në Ambasadën e Kosovës ofroi koordinim përgjatë shpërndarjes së librave që bën Ambasada e Kosovës nëpër biblioteka të ndryshme në Austri, duke sjellë më pranë mundësinë që edhe botimet e autorëve të Lidhjes sonë të përfshihen në këto kontingjente. Hazir Mehmeti në adresimin e tij kërkoi më shumë fokusim në inkuadrimitin e të rinjve në Lidhje. Edhe anëtari i Lidhjes nga Linz-i, Ramiz Selimi potencoi rëndësinë e aktiviteteve të LShKShA, të cilat ndikojnë pozitivisht tek gjeneratat e reja dhe shtyrjen e asimilimit potencial të tyre. Ai kërkoi më tepër përkushtim në joshjen e të rinjve për t'u aktivizuar në subjektet kulturore, sidomos në LShKShA.

Raporti financiar:

Raporti financiar, i cili në formë tabelore u ishte shpërndarë paraprakisht të pranishmëve, u prezantua nga Anton Marku. Ai tha se "mënyra e financimit të LSHKSHA bëhet kryesisht në baza vullnetare, përmes pagesës së anëtarësisë në shumën prej 50 € në vit. Formë tjetër e financimeve kanë qenë donacionet nga sipërmarrësit shqiptarë në Vjenë dhe nga institucionet austriake, kryesisht nga qyteti i Vjenës (MA7 dhe MA17). Shpenzimet kryesore ishin: mirëmbajtja e faqes së Lidhjes, botimi i dy antologjive, pagesa e lokacioneve për organizime, kompensimet për autorët që vijnë nga larg dhe ndarja e herëpashershme e honorarëve për autorët që lexuan në orët letrare. Për të gjitha shpenzimet e bëra ekzistojnë fletëpagesa dhe fletëdëshmi të ruajtura në arkivin e Lidhjes. Shuma totale e të hyrave përgjatë viteve 2011-2015 ka qenë 9.418,15 €, daljet (shpenzimet) kapin shifrën prej 9.178,12 €, ndërsa në xhirollogarinë e lidhjes janë edhe 190,15 €."

Prezantimi i planit të veprimit të LShKShA "Aleksandër Moisiu" për vitin 2016

Kuvendi vazhdoi punimet me paraqitjen e planit të aktiviteteve për vitin që vjen, të cilin, në formë tabelore e bëri Anton Marku. Ai theksoi se "përderisa gjatë vitit 2015 janë realizuar 75% e aktiviteteve të planifikuara, gjatë vitit 2015 janë parashikuar të mbahen 6 orë letrare (në Vjenë dhe qytetin e Baden-it), disa promovime librash dhe pjesëmarrje në orët letrare të organizuara nga LKShM me seli në Koblenz në Gjermani dhe aktivitetet në vendlindje. Një prioritet do t'i kushtohet mundësisë së botimit të numrit të dytë të antologjisë së krijuesve shqiptarë në Austri si dhe zhvillimit të kuvendit të LKShM, në rast se Ministria e Diasporës e Republikës së Kosovës ofron mbështetje financiare për këtë projekt".

Në lidhje me këtë Hazir Mehmeti propozoi që fokusi i aktiviteteve të jetë në promovimin e librave të botuara nga anëtarët e Lidhjes dhe në përpjekjen për thellimin e bashkëpunimit me institucionet e shteteve amë me kërkesa për përkrahjen e projekteve tona në të ardhmen. Ai po ashtu sugjeroi edhe krijimin e një komisioni për vlerësimin e botimeve.

Pranimi i anëtarëve të rinj dhe zgjedhja e kryesisë së re

Duke marrë parasysh faktin se Lidhja jonë ka vendosur kontakte edhe me disa krijues tjerë shqiptarë që jetojnë në Austri, e që ende nuk janë zyrtarisht anëtarë të këtij subjekti, u propozua që t'u ofrohet anëtarësimi edhe këtyre krijueseve dhe krijuesve: Jeta Jashari, studente (e cila ishte e pranishme në kuvend dhe pranoi nominimin/anëtarësimin), Gjergj Kola dhe Gjergj Rrustaj me vendbanim në Vjenë dhe Gjon Keka, student/doktorant në Graz.

Pas sqarimeve të bëra në përputhje me statutin e Lidhjes lidhur me zgjedhjen e kryesisë (paragrafi 11, pika 1), kuvendi vendosi, me shumicë votash, që të aprovojë listën e propozuar për anëtarë të kryesisë të sugjeruar nga kryesia e deritanishme e Lidhjes, me këtë përbërje:

Besim Xhelili, Anton Marku, Vjollca Koni, Zef Ndrecaj, Ramiz Selimi, Hazir Mehmeti, Ragip Dragusha, Jehona Sukaj dhe Ajet Shira. Më pas, kryesia e re u tërhoq për të bërë zgjedhjen e udhëheqësve të saj. Në vazhdim, kryesuesi i punimeve të kuvendit Hazir Mehmeti bëri të ditur edhe propozimet të cilat u miratuan unanimitisht. Kryesia e re e LShKShA në mandatin e ri katërvjeçar do të ketë këtë përbërje:

Anton Marku	kryetar
Vjollca Koni	nënkryetare
Ramiz Selimi	nënkryetar
Zef Ndrecaj	nënkryetar
Ragip Dragusha	sekretar
Jehona Muja	arkëtare
Hazir Mehmeti	anëtar
Ajet Shira	anëtar

Besim Xhelili kryetar nderi

Më pas, Besim Xhelili falënderoi kryesinë e deritanishme për bashkëpunimin përgjatë katër viteve të kaluara dhe i uroi punë të mbarë kryesisë së re. Edhe kryetari i porsazgjedhur Anton Marku falënderoi anëtarët e kuvendit për besimin dhe mbështetjen e dhënë, duke premtuar angazhim të sigurtë në promovimin e kulturës shqiptare në Austri dhe vendosjen e urave të komunikimit me autorë dhe institucione austriake, si dhe me krijues të tjerë që jetojnë dhe veprojnë në Austri. Në emër të KShShA kryesinë e re e përgëzuan Januz Saliuka si dhe Dr. Sabri Osmani.

Të ndryshme:

Në këtë pikë të rendit të ditës, Zef Ndrecaj propozoi që anëtari i Lidhjes sonë Dan Kosumi, i cili tashmë jeton në Zvicër, të nominohet për anëtar nderi i Lidhjes.

Në fund, Anton Marku duke falënderuar pjesëmarrësit për praninë e tyre në këtë aktivitet, shpalli të mbyllur kuvendin e parë zgjedhor të LShKShA-së, i cili përfundoi punimet me një koktej rasti.